



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2023

VENDIM

Nr. 33, datë 18.01.2023

PËR

**KONFIRMIMIN SI NDIHMËSMAGJISTRAT NË GJYKATËN E LARTË TË
GJYQTARES {...} DHE PËRSËRITJEN E MANDATIT TË KOMANDIMIT ME 3 (TRE)
VITE**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61, 86, shkronja “d” dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 53, dhe 56, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 34 pika 4 e Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 4 datë 18.01.2018 të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë si dhe mbi kërkesën e Gjykatës së Lartë, dërguar me Shkresën nr.5332/1 prot., datë 11.10.2022, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Konfirmimin si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë të gjyqtares {...}, duke vendosur përsëritjen e mandatit të komandimit me tre vite.
2. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data 19.01.2023.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës së Lartë si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR